



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 141

Tiranë – E Premte, 12 Shtator 2014

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i KM nr. 568, datë 3.9.2014	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për punësimin fitimprurës të anëtarëve të familjes së misionit diplomatik ose postit konsullor.....	6547
Vendim i KM nr. 569, datë 3.9.2014	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, mbi aktivitetin fitimprurës të personave të varur të anëtarëve të misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore.....	6548
Vendim i KM nr. 589, datë 10.9.2014	Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale.....	6550

**VENDIM**

Nr. 568, datë 3.9.2014

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR PUNËSIMIN
FITIMPRURËS TË ANËTARËVE TË
FAMILJES SË MISIONIT DIPLOMATIK OSE
POSTIT KONSULLOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për punësimin fitimprurës të anëtarëve të familjes së misionit diplomatik ose postit konsullor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR PUNËSIMIN FITIMPRURËS
TË FAMILJARËVE TË ANËTARËVE TË
PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE OSE
KONSULLORE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,
me dëshirën për të përmirësuar mundësitë e punësimit fitimprurës të familjarëve të anëtarëve të përfaqësive diplomatike ose konsullore,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1**Përkufizime**

Për marrëveshjen:

1. “Anëtar i një përfaqësie diplomatike apo konsullore” është çdo punonjës vendas i shtetit

dërgues i emëruar në një përfaqësi diplomatike apo konsullore ose në një mision të një organizate ndërkombëtare në shtetin pritës.

2. “Familjar” është bashkëshorti/-ja, partneri/-ja dhe fëmijët, të cilët janë pjesë e përhershme e familjes së anëtarit të përfaqësisë diplomatike ose konsullore në shtetin pritës, si edhe persona të tjerë, që janë pjesë e familjes së anëtarit vendas të përfaqësisë diplomatike ose konsullore, përkundrejt të cilëve anëtari vendas i përfaqësisë ka detyrime ligjore apo morale, apo me të cilët anëtari vendas ka qenë duke bashkëjetuar apo për mirëqenien e të cilëve anëtari vendas ka qenë përgjegjës në momentin e dërgimit në shtetin pritës, dhe të cilët nuk janë të punësuar prej anëtarit vendas të përfaqësisë.

3. “Punësim fitimprurës” është çdo formë e punësimit shpërblyes, i vetëpunësuar apo i punësuar, duke përfshirë edhe kualifikimet profesionale.

Neni 2**Leje për t’u angazhuar në punësim fitimprurës**

1. Familjarëve të familjes duhet t’u jepet leje, që të mund të angazhohen në punësim përfitues në shtetin pritës, duke respektuar parimin e reciprocitetit. Pavarësisht lejes së punës, të dhënë në bazë të kësaj marrëveshjeje, duhet të zbatohen rregullat e lidhura me profesionet specifike në shtetin pritës. Individët e interesuar përjashtohen nga kushti për të marrë leje qëndrimi edhe kur fillojnë punë fitimprurëse në Republikën Federale të Gjermanisë. Në Republikën e Shqipërisë lejet përkatëse të qëndrimit do të jepen kur të jetë e nevojshme.

2. Në raste të veçanta, familjarët mund të vazhdojnë punësimin e tyre fitimprurës për një periudhë të përshtatshme dhe të kufizuar kohore pa leje qëndrimi dhe/ose pa leje punësimi (të BE-së) edhe pasi detyra e anëtarit të përfaqësisë diplomatike apo konsullore në shtetin pritës ka përfunduar.

Neni 3**Procedurat**

Përfaqësia diplomatike e shtetit dërgues duhet të njoftojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të shtetit pritës për fillimin dhe mbarimin e punësimit fitimprurës për familjarin përkatës.



Neni 4

Imuniteti ndaj juridiksionit civil dhe administrativ

Nëse familjarët kanë imunitet ndaj juridiksionit civil dhe administrativ të shtetit pritës në përputhje me Konventën e Vjenës të datës 18 prill 1961 për marrëdhëniet diplomatike apo sipas instrumenteve të tjera ndërkombëtare të zbatueshme, ky imunitet nuk është i zbatueshëm për veprime apo mosveprime në lidhje me punësimin fitimprurës.

Neni 5

Imuniteti ndaj juridiksionit penal

1. Në rastin e familjarëve, të cilët kanë imunitet ndaj juridiksionit penal të shtetit pritës në përputhje me Konventën e Vjenës të datës 18 prill 1961 për marrëdhëniet diplomatike, ose sipas instrumenteve të tjera të zbatueshme ndërkombëtare, dispozitat në lidhje me imunitetin ndaj juridiksionit penal të shtetit pritës duhet të zbatohen edhe për veprimet e kryera në lidhje me punësimin fitimprurës. Megjithatë, në rast të një veprimi penal, shteti dërgues duhet të shqyrtojë mundësitë e heqjes së imunitetit të familjarit në fjalë ndaj juridiksionit penal të shtetit pritës.

2. Nëse shteti dërgues nuk heq imunitetin e familjarit në fjalë, ai do të njoftojë autoritetet e veta të ndjekjes penale për çdo vepër penale të kryer nga ai person. Shteti pritës duhet të njoftohet për përfundimin e procedurave penale.

3. Familjari mund të merret në pyetje në cilësinë e dëshmitarit lidhur me punësimin fitimprurës, për sa kohë që shteti dërgues gjykon se kjo nuk do të jetë në kundërshtim me interesat e tij.

Neni 6

Sistemi tatimor dhe sigurimet shoqërore

Familjarët janë subjekt i sistemit tatimor dhe sigurimeve shoqërore të shtetit pritës në lidhje me punësimin e tyre fitimprurës në atë shtet, nëse kjo nuk bie ndesh me instrumente të tjera ndërkombëtare.

Neni 7

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën që Qeveria e Republikës së Shqipërisë njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, që ka përfunduar procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Data e hyrjes në fuqi do të jetë dita e marrjes së njoftimit.

Faqe | 6548

2. Kjo marrëveshje mund të zgjidhet nga të dyja palët kontraktuese pas në afati 5-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi, duke lajmëruar 6 muaj përpara.

Nënshkruar në Berlin në datën 3 korrik 2014 në dy kopje, në gjuhën shqipe, gjermane dhe angleze, ku të tre tekstet janë autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM

Nr. 569, datë 3.9.2014

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLOVENISË, MBI AKTIVITETIN FITIMPRURËS TË PERSONAVE TË VARUR TË ANËTARËVE TË MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE ZYRAVE KONSULLORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, mbi aktivitetin fitimprurës të personave të varur të anëtarëve të misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLOVENISË, MBI AKTIVITETIN FITIMPRURËS TË PERSONAVE TË VARUR TË ANËTARËVE TË MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE ZYRAVE KONSULLORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë,



me dëshirën për të lidhur një marrëveshje, me synim lehtësimin e aktivitetit fitimprurës të personave të varur të anëtarëve të misioneve diplomatike dhe zyrove konsullore të shtetit dërgues në territorin e shtetit pritës,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Të dy qeveritë pranojnë që, mbi bazën e reciprocitetit për personat e varur të punonjësve të akredituar të shtetit dërgues të caktuar me detyrë zyrtare në shtetin pritës si anëtarë të misioneve diplomatike ose të një zyre konsullore, të marrin autorizim për të filluar aktivitet fitimprurës në shtetin pritës.

Neni 2

1. Anëtar i një misioni diplomatik ose zyre konsullore është një punonjës i shtetit dërgues i cili nuk është shtetas i shtetit pritës dhe i cili është caktuar me detyrë zyrtare në shtetin pritës në një mision diplomatik, zyrë konsullore ose mision në një organizatë ndërkombëtare.

2. Persona të varur janë:

- a) bashkëshortët ose partnerët sipas ligjit;
- b) fëmijët e pamartuar të varur të punonjësve deri në 18 ose 26 vjeç nëse ndjekin me kohë të plotë si student një institucion arsimor pas shkollës së mesme; dhe
- c) fëmijët e pamartuar të varur të punonjësve të cilët janë me aftësi të kufizuar, fizike ose mendore.

Neni 3

1. Asnjë kufizim nuk mund të vendoset mbi tipin e aktivitetit fitimprurës që mund të fillohet. Megjithatë, në profesionet ku kërkohen kualifikime të caktuara, do të jetë e nevojshme që personi i varur të përmbushë këto kualifikime.

2. Autorizimi për të filluar një aktivitet fitimprurës mund të refuzohet, në rastet kur, për shkaqe të sigurisë, mund të punësohen vetëm shtetas të shtetit pritës.

3. Çdo leje për të filluar një aktivitet fitimprurës në shtetin pritës mbaron me përfundimin e emërimit të punonjësit.

Neni 4

1. Para se një person i varur mund të fillojë një aktivitet fitimprurës në shtetin pritës, misioni diplomatik i shtetit dërgues i bën një kërkesë zyrtare

sektorit të protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pritës.

2. Pas verifikimit që personi në fjalë përfshihet brenda kategorive të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe pas respektimit të procedurave të brendshme të zbatueshme, sektori i protokollit njofton menjëherë dhe zyrtarisht misionin diplomatik që personi ka leje për të filluar aktivitet fitimprurës pas përmbushjes së kërkesave ligjore në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në shtetin pritës, duke lëshuar, sipas rastit, lejen e punës.

Neni 5

1. Për personat e varur, të cilët fillojnë aktivitet fitimprurës sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të cilët kanë imunitet nga juridiksioni i shtetit pritës në pajtim me Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike ose Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, shteti dërgues heq dorë në mënyrë të paravokueshme nga imuniteti, nga juridiksioni civil dhe administrativ në lidhje me të gjitha çështjet që rrjedhin nga ky aktivitet fitimprurës.

2. Në rast se një person i varur, i cili ka imunitet nga juridiksioni penal në pajtim me Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike ose Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, akuzohet për një veprë penale të kryer në lidhje me aktivitetin e tij ose të saj fitimprurës, shteti dërgues shqyrton me kujdes çdo kërkesë me shkrim që mund të paraqitet nga shteti pritës për heqjen dorë nga ky imunitet.

Neni 6

Personat e varur që fillojnë aktivitet fitimprurës sipas kësaj Marrëveshjeje u nënshtrohen regjimeve fiskale dhe të sigurimeve shoqërore të shtetit pritës për të gjitha çështjet në lidhje me aktivitetin e tyre fitimprurës në atë shtet.

Neni 7

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet kanaleve diplomatike, që të gjitha kërkesat e nevojshme të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur.

Neni 8

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund ta prishë këtë në çdo kohë duke bërë një njoftim me afat gjashtëmuor me shkrim drejtuar palës tjetër.



Bërë në Lubjanë, më 16 qershor 2014, në dy kopje, në gjuhën shqipe, sllovene dhe angleze, ku të tre tekstet janë njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM

Nr. 589, datë 10.9.2014

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË EVIDENTIMIT FAKTIK, NË TERREN, TË NDËRTIMEVE PA LEJE/SHTESAVE NË NDËRTIME ME LEJE, TË ORGANEVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR PROPOZIMIN DHE MIRATIMIN E ZONAVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 45/1, pika 1, të ligjit nr. 9482 datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje, shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale.

I. EVIDENTIMI FAKTIK NË TERREN I NDËRTIMEVE PA LEJE/SHTESAVE NË NDËRTIME ME LEJE

1. Drejtoritë e varësisë të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) të kryejnë evidentimin në terren dhe hartimin e dokumentacionit në bazë të gjendjes faktike të ndërtimeve pa leje, shtesave në ndërtimet me leje, në vijim të quajtura “ndërtime informale”, sipas njërive strukturore të përcaktuara prej tyre, rast pas rasti.

Në procedurat e evidentimit e të hartimit të dokumentacionit të gjendjes faktike përfshihen:

a) përditësimi i të dhënave të gjendjes ndërtimore të ndërtimeve informale;

b) plotësimi i procesverbalit të konstatimit, sipas modelit të miratuar me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI);

c) harta e përditësuar e ndërtimeve informale në formatin elektronik dhe “hard copy”, si dhe dokumentacioni teknik (genplan, planimetri).

2. Për ndërtimet informale, që përfshihen për herë të parë në procedurat e legalizimit, sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, plotësohet deklarata për përfshirje në këtë proces nga subjektet poseduese.

Forma, mënyra e administrimit dhe afati kohor i plotësimit të deklaratës përcaktohen me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).

3. Verifikimi i ndërtimeve informale, brenda periudhave kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhet nëpërmjet të paktën njëres prej formave të mëposhtme:

a) Përdorimit të produktit të fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë, për periudhën kohore që ai mbulon.

b) Imazheve satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjektet disponuese.

c) Përdorimit të planrilevimeve në kuadër të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, të administruara nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

ç) Vërtetimit me mënyra alternative, nëpërmjet çdo dokumenti tjetër, juridikisht të vlefshëm, që provon ekzistencën e ndërtimit informal në momentin kohor të dhënë (në një datë dhe vend të caktuar).

Dokumentacioni, i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit.

4. Për kryerjen e procedurave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) mund të autorizojë subjekte private, të licencuara, në fushat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

II. MIRATIMI I ZONAVE INFORMALE DHE DOKUMENTACIONI I ZBATUESHËM

5. Drejtoritë në varësi të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) duhet të kryejnë procedurat e evidentimit në terren, të përgatitjen e dokumentacionit dhe gjendjes faktike të ndërtimeve informale, si dhe të hartojnë dokumentacionin teknik e ligjor për zonën informale.



6. Zonë informale do të konsiderohet territori me sipërfaqe mbi 2 hektarë, i zënë nga ndërtime informale, procesi i legalizimit të të cilave nuk u nënshtrohet kushteve të instrumenteve të planifikimit të territorit.

Drejtoritë në varësi të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), për propozimin e zonës informale, orientohen nga:

- a) evidentimi faktik i ndërtimeve informale në territorin përkatës;
- b) vija kufizuese administrative e njërive të qeverisjes vendore;
- c) morfologjia dhe kushtet e relievit;
- ç) gjendja e pronësisë dhe cilësitë juridike të territorit.

7. Propozimi i zonës informale përbëhet nga dokumentacioni, si më poshtë vijon:

- a) Harta e zonës informale e përditësuar në shkallën 1:1000 deri 1:2500, ku të pasqyrohet:
 - i) vija kufizuese e re e propozuar;
 - ii) vija kufizuese e rishikuar e zonës informale në lidhje me atë të mëparshme;
 - iii) vija kufizuese administrative e njësisë/ve së/të qeverisjes vendore;
 - iv) kufiri i zonave kadastrale;
 - v) kufiri i territoreve dhe objekteve që gëzojnë cilësi juridike të veçanta.
- b) Tabela përmbledhëse, ku pasqyrohen të dhënat për ndërtimet informale;
- c) Harta e shkallës 1:2500 deri në 1:25000, ku paraqitet zona e propozuar në raport me kufijtë administrativë;
- ç) Relacioni përshkrues dhe argumentues i propozimit me të dhëna statistikore për zonën informale.

8. Propozimi për zonën informale dhe dokumentacioni i hartuar, sipas pikës 7, të këtij vendimi, depozitohet për shqyrtim në këshillin teknik, organ kolegjal pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).

9. Këshilli teknik ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në këtë vendim dhe në aktet e tjera nënligjore. Përbërja dhe organizimi i tij përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

10. Kontrolli dhe vlerësimi i dokumentacionit sipas pikës 7, të këtij vendimi, kryhen nga këshilli teknik brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit të tij.

11. Dokumentacioni i përpunuar nga këshilli teknik paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit, sipas përcaktimeve të nenit 11, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

12. Vendimi nr. 515, datë 13.5.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe këshillave të qarqeve gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, të ndryshuar, dhe udhëzimi nr. 6, datë 8.11.2006, i ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, shfuqizohen.

13. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Këshilli Kombëtar i Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 8 lekë